

**STATUTI**  
**I SHOQERISE' ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"TRILOGIK" SH.P.K..**

Sot ,me 22/10/2019 , ne baze te Kushtetutes dhe te Kodit Civil ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, ne baze te ligjit ne fuqi Nr 7512 ,date 08.10.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private Sipermarrjeve te lira dhe aktiviteve private dhe privatizimit" te ligjit N.9901 ,date 14.04.2008, "Per marredheniet tregtare" dhe ne baze te ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per qendren kombetare te regjistimeve" ,qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare,me vullnetin e saj te lire ,te nenshkruar ne kete Statut,i cili vlen dhe si Akt Themelimi:

**ALESSIO GATTI** lindur ne BARI (BA) me 26/03/1993 ne Itali me numer dokumenti AY5278155, i cili ka vendosur te hartohet Statuti i nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar, aktiviteti i se ciles do te rregullohet mbi bazen e Legjislacionit Shqiptar ne fuqi, sipas Akt Themelimit dhe Statutit te Shoqerise bashkangjitur.

**Neni 1 – Emertimi**

1.1 Emertimi i Shoqerise eshte **TRILOGIK Sh.p.k.** (e cilesuar me poshte si "Shoqeria").

**Neni 2 – Forma ligjore**

2.1 Shoqeria **TRILOGIK Sh.p.k.** eshte e themeluar si Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar dhe eshte e rregulluar sipas Statutit te saj si me poshte vijon,dhe ka vlore ne baze te legjislacionit shqiptar dhe si Akt Themelimi

2.2 Shoqeria operon ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

**Neni 3 – Selia**

3.1 Shoqeria operon me seli ne adresen: Tirane ,Ruga Deshmoret e 4 Shkurtit,Pallati 68,Hyrja 10,Kati 4,Apartamenti 15.

3.2 Shoqeria mund te kete zyra, dege, perfaqesi dhe agjensi si brenda Shqiperise ashtu edhe jashte shtetit shqiptar.

3.3 Mbledhja e Ortakeve,mund te vendose, transferoje dhe/ose te mbylle, si brenda edhe jashte shtetit shqiptar, dege sekondare, filiale,seli, agjensi, zyra perfaqesimi dhe bashkesi lokale te cdo natyre.



#### Neni 4 – Objekti social

Qëllimi i kompanisë është çdo transaksion i ligjshëm tregtar që përfshin, por pa kufizim në, aktivitetet e mëposhtme:

-Logistikë të ndermarrjes dhe menaxhim te strukturave te lidhjes te tranzitit; menaxhimi i terminaleve dhe platformave te konteniereve; hekurudhore; portuale dhe aeroportuale përvete dhe të tretë; përllogari të të tretëve; me mjete vetjake dhe të të tretëve;

-Realizim; ushtrim dhe koordinim i shërbimeve të lidhura direkt me logistikën të aplikuar në transport dhe të lëvizjes së mallrave; punë hamalli; menaxhim magazinash dhe ruajtje mallrash; menaxhim shërbimesh në operacione imbarkim; zbarkimi, trasbord, depozitë dhe lëvizje në përgjithësi të kryer me ndihmën e mjeteve mekanike ose të ndryshme; ngarkim dhe shkarkim mallrash në përgjithësi:

- Menaxhim vetjak dhe përllogari të të tretëve të zonave të pajisura përmagazinimin e mallrave dhe imballayhimin e tyre përdërgim; dërgim dhe transport të pakove të llojeve të ndryshme; si edhe të mallrave; kryerjen e veprimeve doganore në lidhje me to; magazinimin; ruajtjen dhe dorëzimin direkt dhe nëprerjet të tretëve të mallrave;

- Ndërtimin; mirëmbajtjen e zakonshme dhe të jashtëzakonshme; restaurimin dhe riparimin ruajtës; rinstrukturimin ndërtimor të ndërtesave civile; industriale dhe të monumenteve; përfshirë punimet e instalimit dhe mirëmbajtjes të impianteve elektronike; elektrike; civile; hidraulike; hidrotermike; ashensorë dhe ngarkues peshash, punime prodhimi dhe vendosje kasash, shërbime lëvizjesh të tokës dhe gërmime:

- Punime dhe lidhje pjesësh në kuadër të sektorit të prodhimit.

Shoqëria mund të krzejë të gjitha veprimet të patundshme; të tundshme dhe tregtare të nevojshme përrarrjen e qëllimit të shoqërisë; përfshirë këtu edhe ato bankare; mund të marrë gjithashtu përsipër; drejtpërsëdrejti ose indirekt pjesëmarrje në biznes; kuota, pjesëmarrje në shoqëri të tjera ose sipërmarrje, të themeluara ose në proces themelimi; blerje degësh ndërmarrjesh që kanë objekt të njëjtë; të përafërt ose të lidhur me këtë, mund të marrë kredi dhe financime dhe të japë garanci të patundshme e të tundshme, reale ose personale; përfshirë edhe garanci bankare; me garanci obligacionesh te vetat pra të shoqërisë në të cilën ka direkt ose indirekt biznese ose pjesëmarrje që janë nën kontroll të përbashkët, por jo në qasje me publikun.



## Neni 5 – Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e shoqerise është vendosur deri më 31 dhjetor 2091 dhe mund të zgjatet.

## Neni 6 – Kapitali

6.1. Kapitali eshte 10.000 (dhjete mijë ) leke i perbere nga 1 (nje) kuote e barazvlefshme me vlerë nominale perkatesisht 10 000 (dhjetemije) leke te **ALESSIO GATTI-s**

6.2 Kapitali i shoqerise eshte plotesisht i regjistruar dhe i leshuar ne menyren e me poshtme:

**ALESSIO GATTI** zoteron 100% (njeqind per qind) te kapitalit te shoqerise i barazvlefshem me 1(nje) kuote.

## Neni 7 – Mundësia e transferimit të kuotave

7.1 Kuotat sociale jane te transferueshme tek palet e treta ne përputhje me dispozitat e akteve nënligjore te parashikuara ne STATUT.

## Neni 8 – Administratorët

8.1 Shoqeria mund te administrohet nga një ose më shumë Administratorë, te lirë te veprojnë veçmas ose bashkarisht sipas asaj që do te vendoset ne rastin e emërimit.

8.2 Administratorët nuk duhet te janë medoemos edhe aksionerë dhe veprojnë ne rolin e tyre derisa te japid dorëheqje ose shkarkohen nga Asambleja e Aksionerëve, ose për një periudhë pesevjecare (5) me mundësinë për tu riemëruar.

8.3 Përfundimi i mandatit te Administratorëve hyn ne fuqi ne momentin kur emërohet organi i ri administrues.

8.4 Administratorëve u takon te përfaqësojnë Shoqerinë ndaj palëve te treta dhe ne gjykim dhe kompetencat më te gjëra administrative, që mund te ushtrohen ne harmoni me atë që përcakton artikulli 95 i ligjit Nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe ndryshime pasuese, por ne çdo rast, brenda kufijve te përcaktuar ne rastin e emërimit dhe nga ky Statut.

8.5 Administratorët mund te emërojnë prokure te veçantë për një akt ose një sërë aktesh.

8.6 Funkioni administrativ kryhet sipas nje tarife te parashikuar ne ligj. Administratorëve u takon rimbursimin e shpenzimeve që kanë ne lidhje me funksionin e tyre administrativ.

8.7 Me kete akt themelimi vendoset si Administrator i Shoqerise:

**ALESSIO GATTI** lindur ne BARI (BA) me 26/03/1993 ne Itali dhe me numer dokumenti AY5278155.



### **Artikull 9 – Gjuha**

- 9.1 Ky Statut hartohet në gjashtë (6) kopje, tri (3) në gjuhën shqipe dhe tri (3) në gjuhën italiane.
- 9.2 Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë lidhur me interpretimin e këtij Statuti, versioni i tij në gjuhën italiane do të jetë i vetmi me vlerë të detyrushëm ligjor.
- 9.3 Ky akt miratohet në çdo artikull nga themeluesit e vetëm te Shoqërisë **TRILOGIK Sh.p.k.** 'i cili nenshkruan me emrin, mbiemrin dhe firmën e vet të gjitha kopjet.

\* \* \*

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**

**ALESSIO GATTI**

ALESSIO GATTI

